

VENDIM
Nr.624, datë 14.5.2008

PËR SHPRONËSIMIN, PËR INTERES PUBLIK, TË PRONARËVE TË PASURIVE TË
PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË PREKEN NGA NDËRTIMI I SEGMENTIT RRUGOR
FIER-BALLSH-TEPELENË (POVLA 2)

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 5, pika 1, 20 e 21 të ligjit nr.8561, datë 22.12.1999 “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik”, dhe të nenit 8 të ligjit nr.9464, datë 28.12.2005 “Për Buxhetin e Shtetit të vitit 2006”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga ndërtimi i segmentit rrugor Fier-Ballsh-Tepelenë (Povla 2).

2. Shpronësimi të bëhet në favor të Drejtorisë së Përgjithshme të Rrugëve.

3. Pronarët e pasurive të paluajtshme, pronë private, që shpronësohen, të kompensohen, në vlerë të plotë, sipas masës, që paraqitet në tabelën, që i bashkëlidhet këtij vendimi, pjesë përbërëse e tij, për sipërfaqen 5007 (pesë mijë e shtatë) m² tokë, e vlerësuar me 542 (pesëqind e dyzet e dy) lekë/m², me vlerë shpronësimi 2 713 794 (dy milionë e shtatëqind e trembëdhjetë mijë e shtatëqind e nëntëdhjetë e katër) lekë, për kultura bujqësore, të vlerësuar në shumën 50 750 (pesëdhjetë mijë e shtatëqind e pesëdhjetë) lekë, për drufrutorë, të vlerësuar në shumën 80 000 (tetëdhjetë mijë) lekë, me vlerë të përgjithshme shpronësimi 2 844 544 (dy milionë e tetëqind e dyzet e katër mijë e pesëqind e dyzet e katër) lekë.

4. Shpenzimet procedurale, në shumën 392 500 (treqind e nëntëdhjetë e dy mijë e pesëqind) lekë, të përballohen nga Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve.

5. Vlera e përgjithshme e shpronësimit, prej 2 844 544 (dy milionë e tetëqind e dyzet e katër mijë e pesëqind e dyzet e katër) lekësh, të përballohet nga llogaria e veçantë e Ministrisë së Financave “Fondi i shpronësimeve”, pranë Bankës së Shqipërisë.

6. Shpronësimi të fillojë më 15 maj dhe të përfundojë më 30 qershor 2008.

7. Pronarët e përmendur në listën, që i bashkëlidhet këtij vendimi, për të cilët është bërë shënimi “Në proces regjistrimi”, të kompensohen, për efekt shpronësimi, pas përfundimit të procesit të regjistrimit dhe pasi të kenë paraqitur dokumentacionin e plotë të pronësisë pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Rrugëve.

8. Ngarkohen Ministria e Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit dhe Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve për zbatimin e këtij vendimi.


Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

REPUBLIKA E SHQIPËRIË
M P P T T
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E RRUGËVE
DREJTORIA E SHPRONËSIMEVE

LISTA E PRONARËVE QË SHPRONËSOHEN NGA REHABILITIMI
I RRUGËS FIER-BALLSH-TEPELENË NR. (1-6)

Nr.	Pronari Emër	Mbiemër	Nr. pasurisë	Sip/shpronësimi arë, pemë m ²	Çmimi në lek/m ²	Vlera në lekë	Vlera kulturës bujqësore	Vlera kulturës drufrutor	Totali	Shënime
1.	Nuredin	Mukaj	124/9	1066	542	577772	10980		588752	Proces regjistrimi
2.	Hysen	Mukaj	124/20	1617	542	876414	16979		893393	Proces regjistrimi
3.	Hysen	Xhaferi	124/25	222	542	120324	2220		122544	Proces regjistrimi
4.	Shyqiri	Kapllani	124/27	358	542	194036	3401	60000	257437	Proces regjistrimi
5.	Halil	Halilaj	122/1	1717	542	930614	17170		947784	Proces regjistrimi
6.	Musa	Kapllani	276/15	27	542	14634		20000	34634	Proces regjistrimi
		Shuma				2713794	50750	80000	2844544	




BRESHQIQA, KOVIL
RREUGA NACIOUALE DALLSH TEPELENI

PLANIMETRIA
GJENDJA EKZISTUESE

SH. 1:500

Superfaqe e gjendje aktuale
qne pranon shprehur nry

NUEDRIA MUKA22 (KONTURI I RRESHQIT)



Superfaqe per cille e abshentuar

S1-S74 = 4208.142
202
S2020.74